



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.130 dt.30.10.2001

**PER
NJE NDRYSHIM NE STRUKTUREN ORGANIZATIVE TE BASHKISE SE
TIRANES**

Në mbështetje të Ligjit Nr.8652 dt.31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, neni 32, gërma ç, Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.215 dt.14.11.2000 “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë së Tiranës”, pasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë Juridike dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve Njerëzore dhe Informacionit, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Këshilli Bashkiak

V E N D O S I

1. Të miratojë ndryshimin në strukturën organizative të Drejtorisë Juridike, sipas skemës bashkëngjitur me këtë përbërje
 - Drejtori
 - Sektori i Marrëdhënieve me Institucionet dhe Qytetarët (3 juristë dhe shefi i sektorit)
 - Sektori i Legjislacionit (2 juristë dhe shefi i sektorit)
 - Sektori i Koordinimit Ligjor (4juristë dhe shefi i sektorit)
2. Efektet financiare të mbulohen nga fondi i pagave sipas buxhetit

3. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Njerëzore dhe Informacionit dhe Drejtoria Juridike me zbatimin e këtij Vendimi
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KRYETARI

Leonidha TOSKA

